

V E N D I M

PER THIRJEN E Mbledhjes per Miratimin e Shperndarjes se Pare te Mases se Falimentit

Sot ne date 25. 11. 2019 une gjyqtari i Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, **Ervin Pollozhani**, si gjyqtar i vetem,

KONSTATOVA :

Se, me kerkesen Nr. 8621 Prot. depozituar me dt. 14. 11. 2019 ne gjykate nga administratorja e falimentit se bashku me aktet shoqeruese, me qellim shqyrtimin e kerkeses per miratimin e shperndarjes se pare te fondeve te mbledhura dhe miratimi i shperblimit te administratores se falimentit dhe Komitetit te Kreditoreve, gjykata mbeshtetur ne nenet 36-38, 45, 50-51, 150 e vijues te ligjit 8901/2002 caktoi nje mbledhje te posaçme, per më datën 22. 11. 2019 ora 14:00, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Salla 7, Kati i 4 , ku:

Rendi i dites do te ishte:

- ✓ *Miratimi i shperndarjes se fondeve te mbledhuara nga shitja e pasurive te luajtshme ne pronesi te shoqerise "Belle Air"shpk si dhe miratimi i shperblimit te administratorit te Falimentimit dhe Komitetit te Kreditoreve per Shoqerine "Belle Air" sh.p.k. shoqeri ne falimentim.*
- ✓ *Çeshtje te tjera.*

Ne kete mbledhje nga ana e gjykates pasi jane vleresuar aktet shoqeruar kerkeses dhe vendimmarrjet e marra nga Komiteti i Kreditoreve dhe administratores se falimentit ne dt. 30. 11. 2019, pasi zhvilloi diskutimet me Komitetin e Kreditoreve prezent dhe administratoren e falimentit, konkludoi se Administratorja e falimentimit e subjektit « Belle Air » sh.p.k. gezon te drejten e perfitimit te shperblimit per punen e kryer gjate procedures se falimentimit, e cila e perlllogaritur per shumen e aktivitet te grumbulluar 10-50 milion lek eshte 5. 5 - 6.5 % te mases se falimentimit.

Sipas perlllogritjeve te bera prej saj-administratores se falimentit, vlere e pare eshte marre ne masen 6. 5% i mases lek +Tvsh = lek + Lek = lek ne total.

Gjykata vleresoi se masa e shperblimit te administratores do te jete ndryshe nga sa ajo dhe komiteti i kreditoreve ka percaktuar dhe konkretisht do te jete ne masen 6. 00% te mases se falimentit dhe ne vlere leku eshte lek + TVSh Lek = lek; duke shtuar dhe shperblimin e Komitetit te Kreditoreve i cili sipas vendimit te gjykates do te jete jo ne masen totale lek neto te cilit i jane zbritur dhe 15 % tatim ne burim, porse do te jete ne masen total lek. Ne kete menyre masa totale dhe perfundimtare do te jete ne shumen lek. Gjykata konkludoi se do te jene keto masat e vlerave te shperndarjes se pare per efekt te shperblimeve.

Ne percaktimin e shperblimit gjykata mori parasysh punen e kryer, rezultatet e arritura, rendesine e falimentimit dhe kujdesin e treguar nga administratorja e falimentimit ne permbushjen e detyrave si dhe te kontributit te Komitetit te Kreditoreve.

Vlerat e reduktuara nga gjykata ne kete faze te pare te shperndarjes ku per administratoren vlere e shperndarjes nga masa 6.5 % do te jete ne masen 6 % te vleres dhe masa e shperblimit te Komitetit te

Kreditoreve do te jete ne masen 50 % te vleres se miratuar prej tyre ku shuma per secilin anetare eshte lek, jane vlera qe si te tilla do te jene pjese e fazave te mevonshme te shperndarjes, kjo nisur nga vleresimi qe gjykata pikese pari i ben nevojave per te plotesuar kerkesat emergjente te kreditoreve te shoqerise ku se pari si te tille dhe masivisht jane punonjesit e saj referuar dhe tabelas bashkangjitur vendimit.

Gjithashtu gjykata pranon dhe njeh dhe shpenzimet e kryera nga administratorja e falimentit gjate procedures se falimentimit te vertetuara me dokumentacionin perkates te njohur dhe pranuar dhe nga komiteti i kreditoreve sipas tabelas perkatese.

Sipas referimeve te administratorit se falimentimit, ne funksion te realizimit te procedurave ligjore te falimentimit jane kryer shpenzimet e evidentuara ne tabelen bashkangjitur kerkeses sipas zerave perkates dhe qe ne vleren totale jane ne masen lek.

Sa me siper Sipas Neni 150 te ligjit percaktohet se : « Ripagimi i kreditoreve te falimentimit mund te filloje vetem pas mbledhjes te verifikimit te pergjithshem. Fondet mund tu shperndahen kreditoreve te falimentimit sapo masa e falimentimit te kete likuiditet te mjaftueshem...Shperndarjet behen nga administratori i falimentimit sipas renditjes se parashikuar nga Neni 605 i K. Civil. Para çdo shperndarje ai duhet te marre mendimin e komitetit te kreditoreve nese eshte caktuar nje i tille ».

Sipas Neni 151 te ligjit percaktohet se : Para çdo shpërndarjeje, administratori i falimentimit harton një liste te pretendimeve qe përfitojnë nga shpërndarja. Lista depozitohet pranë regjistrimit te gjykatës për t'u inspektuar nga palët. Administratori i falimentimit shpall publikisht shumën e përgjithshme te pretendimeve dhe shumën e disponueshme për shpërndarje ne masën e falimentimit”.

Sipas Neni 152 te ligjit percaktohet se: “1. Një kreditor falimentimi, pretendimi i te cilit nuk është vërtetuar dhe nuk është bazuar ne një titull ekzekutiv ose vendim te formës se prere, duhet t'i provoje administratorit ne mënyrë bindëse, jo me vone se dy jave pas shpalljes publike te administratorit, se për gfarë shume është bere padia e vërtetimit te pretendimit ose ka vazhduar padia e ngritur me pare. 2. Ne qofte se kreditori ia vërteton këto fakte administratorit ne mënyrë bindëse dhe ne kohen e duhur, pjesa qe i përgjigjet shumës se pretendimit mbahet gjate shpërndarjes për gjithë kohëzgjatjen e procesit te padisë. 3. Ne qofte se kreditori nuk ia vërteton këto fakte administratorit, ne mënyrë bindëse dhe ne kohen e duhur, pretendimi nuk merret parasysh gjate shpërndarjes.

Sipas Neni 156 te ligjit percaktohet se: Administratori i falimentimit shton ne listën e shpërndarjes çdo ndryshim sipas neneve 152 deri 154 të këtij ligji, brenda tri ditësh nga mbarimi i afatit te përjashtimit te parashikuar ne piken 1 te nenit 152 këtij ligji.

Neni 36 i ligjit percakton se : « Shpenzimet e procedurës se falimentimit dhe shpenzimet e tjera administrative shlyhen nga masa e falimentimit para pretendimeve te kreditoreve te masës se falimentimit. 2. Kreditoret e masës se falimentimit duhet te ngrënë pretendimet e tyre ndaj administratorit te falimentimit dhe t'i përmbushin ato, sipas dispozitave te zbatueshme jashtë procedurës se falimentimit”.

Neni 37 i ligjit perakton se: “Quhen shpenzime te procedurës se falimentimit: a) shpenzimet gjyqësore; b) shpërblimi dhe shpenzimet e administratorit te përkohshëm te falimentimit, te administratorit te falimentimit dhe te anëtarëve te komitetit te kreditoreve”.

Neni 50 i ligjit percakton se: « 1. Administratorja e falimentimit ka te drejten e shperblimit per punen e kryer dhe rimburesimit te shpenzimeve te bera gjate permbushjes se detyres. 2. Masa e zakonshme e shperblimit llogaritet me baze te vleres se mases se falimentimit ne kohen e perfundimit te procedures se

falimentimit. 3. Masa e zakonshme e shperblimit rivleresohet ne varesi te vellimit dhe shkalles se veshtiresise gjate ushtrimit te detyres se administratoros se falimentimit.

Neni 51 percakton se: *“1. Seksioni tregtar i gjykates se rrethit percakton me vendim shperblimin dhe shpenzimet qe duhet ti rimburesohen administratorit te falimentimit. 2. Vendimi i seksionit tregtar te gjykates se rrethit me perjashtim te shumes se parashikuar duhet te shpallet publikisht dhe ti njoftohet personalisht administratorit te falimentimit, debitorit, anetareve te komitetit te kreditoreve, nese eshte emeruar prej tyre. Ne vendimin e seksionit tregtar te rrethit te shpallur publikisht duhet te vihet ne dukje se tekti i plote i vendimit gjendet ne sekretarine e seksionit tregtar te gjykates se rrethit. 3. Kunder vendimit te seksionit tregtar te gjykates se rrethit administratori i falimentimit, debitori dhe cdo kreditor falimentimi kane te drejten e ankimit te vecante ».”*

Neni 52 percakton se: *“Rregulla te hollesishme per kushtet dhe kriteret e percaktimit te mases se shperblimit dhe rimburesimit te shpenzimeve te administratorit te falimentimit caktohen nga Keshilli i Ministrave”.*”

Neni 60 percakton se: *« Anetaret e Komitetit te Kreditoreve kane te drejte te shperblehen per punen dhe te rimbursohen per shpenzimet e arsyetuara. Ne caktimin e shperblimit merret parasysht koha dhe vellimi i punes se anetarit, si dhe zbatohen kerkesat e neneve 51 dhe 52 te ligjit ».*

Ne percaktimin e shperblimit te administratoros se falimentimit dhe vleres se shpenzimeve te rimbursueshme u more ne konsiderate dhe VKM Nr. 197 dt. 13. 04. 2007 *“Per kushtet dhe kriteret e percaktimit te mases se shperblimit dhe shpenzimet e administratorit te falimentimit”.*

Nisur nga keto percaktimeve ligjore dhe pas vendimmarrjeve te mesiperme te bera nga gjykata lidhur me masat e shperblimit per administratoren e falimentit dhe komitetin e kreditoreve, vlerat monetare te hequra ketyre subjekteve tashme do te jene pjese e mases se falimentit (aktivet e disponueshme) per efekt te shperndarjes se pare te saj tek kreditorit sipas Nenit 605 te K. Civil, duke u urdheruar administratorja e falimentit qe te bente edhe njehere rivleresimin e ketyre vlerave per efekt te shperndarjes se tyre, duke paraqitur tabelat perkatese te ripunuara.

Ne kete menyre nga ana e administratoros se falimentit u paraqiten ne gjykate aktet me Nr. 6866 Prot. dt. 25. 11. 2019 qe lidhen me tabelen e perlllogaritjeve per shperndarjen e mases se falimentit ku jane evidentuar pas rregullimeve zerat e *arketimeve, shpenzimeve, shperblimi i administratoros se falimentit ne mases 6 % dhe ai i komitetit te kreditoreve i reduktuar me 50% te mases 5.5 %, masa e mbetur per tu shperndare kreditoreve, fondi rezerve i mases se mbetur per tu shperndare si dhe se fundmi aktivet e disponueshme per shperndarjen e kreditoreve qe ne total jane tashme ndryshe nga vlera e pare, ne shumen 22.000.000 (njezet e dy milion) lek.*

Ne kete menyre me qellim paraqitjen e ketij vendimi dhe bashkangjitur tabelen (listen e punonjesve te shoqerise “Belle Air” shoqeri ne falimentim te cilet perfitojne nga shperndarja e pare), duke e publikuar ate ne faqen zyrtare ne internet te gjykates por dhe te shoqerise si dhe ne kendin e afishimit ne ambientet e gjykates, kjo ne respektim te Nenit 151 te ligjit, gjykata ne repektim te ketyre detyrimeve dhe te afateve ligjore minimale per tu zbatuar, mbeshetur ne nenet 36-38, 45, 50-51, 150, 151-156 te ligjit 8901/2002 cakton nje mbledhje te posaçme, per më **datën 13. 12. 2019 ora 14:00, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Salla 7, Kati i 4**, ku:

Rendi i dites do te jete:

- ✓ *Miratimi i shperndarjes se fondeve te mbledhuara nga shitja e pasurive te luajtshme ne pronesi te shoqerise “Belle Air”shpk si dhe miratimi i shperblimit te administratorit te Falimentimit dhe Komitetit te Kreditoreve per Shoqerine “Belle Air” sh.p.k. shoqeri ne falimentim.*
- ✓ *Çeshtje te tjera.*

Pjesëmarrja e të gjithë kreditorëve, anetareve te Komitetit te Kreditoreve, e debitorit dhe e debitoreve te debitorit “Belle Air” sh.p.k. është e rëndësishme.

Kreditorët/debitorët, persona fizike, duhet të jenë të pajisur me mjet identifikimi.

Perfaqesuesit e kreditorit dhe debitorit duhet te jene te pajisur me akt perfaqesimi (prokure, autorizim) dhe mjet identifikimi.

Per personat kreditore, persona juridike, autorizimit ose prokures duhet t’i bashkelidhet dhe nje ekstrakt i marre nga Qendra Kombetare e Regjistrimit me date leshimi jo me vone se 7 dite para dates se caktuar per mbledhje.

Mungesa e mjetit te indentifikimit apo aktit te perfaqesimi dhe ekstraktit nga QKR, sjell si pasoje mos legjitimimin tuaj nga Gjykata ne Mbledhjen e Posaçme.

Nje kopje e ketij vendimi publikohet ne Faqen Zyrtare te Internetit te Gjykates.

Bashkangjitur ketij vendimi eshte dhe lista e punonjesve te shoqerise “Belle Air” shoqeri ne falimentim te cilet perfitojne nga shperndarja e pare, e cila do te afishohet dhe ne kendin e njoftimeve ne ambientet e gjykates.

Krahas ketij njoftimi/publikimi, ngarkohet dhe Administratorja e Falimentimit Shpresa Breçani te njoftoje kreditorët e debitorit “Belle Air” sh.p.k. dhe debitorët e tij nominalisht per kete date Mbledhjeje.

Tirane me dt. 25. 11. 2019 !

GJYQATAR

ERVIN POLLOZHANI